



Republika e Kosovës/
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit -Ured Premijera -Office of the Prime Minister
*Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova -
Kosovo Agency of Statistics*

Seria 2: Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit

Anketa e Mbeturinave Komunale 2014





Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova -
Kosovo Agency of Statistics

Seria 2: Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit

Anketa e Mbeturinave Komunale 2014



Botuesi: Agjencia e Statistikave së Kosovës (ASK)

Data e botimit: Dhjetor, 2015

© : Agjencia e Statistikave së Kosovës

Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.

Informata të shumta janë në dispozicion në internet, ku mund të qaseni përmes web-faqes së ASK-së në internet:

<http://ask.rks-gov.net/>

Parathënie

Agjencia e Statistikave të Kosovës, konkretisht Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit, ka organizuar dhe realizuar Anketën e mbeturinave komunale për vitin 2014, si anketë e rregullt vjetore.

Qëllimi i kësaj ankete është që të siguroj të dhëna statistikore të qëndrueshme për sektorin e mbeturinave komunale në Kosovë. Rezultatet e prezantuara në këtë publikim ofrojnë një burim të rëndësishëm statistikor për gjendjen e tanishme të këtij sektori.

Të gjitha dokumentet metodologjike që janë përdorur për realizimin e anketës janë në harmoni me rregulloret dhe rekomandimet e BE-së, duke përfshirë edhe Ligjin e Mbeturinave në Kosovë (Nr .02/L-30).

ASK, falënderon ekspertin nga GOPA Jürgen Gonser (AGRUS GmbH, Berlin), për mbështetje profesionale.

Publikim është përgatitur nga:

Bajrush Qevani, Drejtor DSB&M
Haki Kurti, Mr.sc.Shef i Divizionit
Flutura Shosholli, Zyrtare
Liridona Osmani, Zyrtare

Sugjerimet, propozimet dhe vërejtjet lidhur me këtë publikim janë të mirëseardhura dhe të dërgohen në:

E- mail: agricultural@rks-gov.net

Dhjetor 2015

Kryeshef Ekzekutiv i ASK-së

Isa Krasniqi

Shkurtesat dhe Simbolet

BE	Bashkimi Evropian
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
KKP	Kompanitë Komunale Publike
DMD	Derë me Derë
BK	Banesa Kolektive
DSP	Departamenti i Statistikave të Popullsisë
DSBM	Departamenti i Statistikave të Bujqësisë dhe Mjedisit
DPSIR	Gjendja, Indikatorët, Treguesit, Presioni, Përgjegjësit
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
EEA	Agjensioni Evropian për Mjedis

Simbolet

Kg/banorë	Kilogram për banorë/vit/ditë
kg	Kilogram
t	Ton

Në tabelat 3 dhe 4 janë rumbullaksuar shifrat, prandaj mund të këtë mospërputhje të lehtë të shumave të prezantuara.

P ë r m b a j t j a

Objektivat e anketës	6
Metodologjia.....	6
Procedurat në terren.....	7
Definicioni	7
Rezultatet.....	8
Tabela 1	8
Tabela 2	9
Krahasimi i të dhënave 2007-2014.....	10
Tabela 3.....	10
Tabela 4.....	12
Aneksi 1 Pyetësi.....	13

Përmbajtja

Anketa e Mbeturinave Komunale, është realizuar sipas modelit DPSIR, i cili është i adoptuar nga grupi i shteteve të OECD-se, EUROSTAT, Agjencionit Evropian për Mjedis (EEA) dhe gjithashtu bazuar në regjistrin e indikatorëve mjedisor sipas EEA.

1. Objektivat

Objektivi i anketës së mbeturinave komunale 2014, është që të sigurojë të dhëna statistikore për mbeturinat komunale për:

- Grumbullimin e mbeturinave komunale dhe
- Të siguroj bazën e monitorimit të mbeturinave komunale në të ardhmen në këtë sektor.
- Të krijoj serinë kohore.

1.2 Metodologjia

1.2.1 Korniza e anketës

Në shtator 2015 janë bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për realizimin e anketës së AMK 2014 duke filluar nga:

Përgatitja e pyetësorit, udhëzuesit, testimit të pyetësorit në kompani publike që merren me menaxhim të mbeturinave komunale, finalizimi i listës së kompanive të cilat merren me menaxhimin e mbeturinave komunale për para datës së fillimit të anketës, si dhe shpërndarja e materialit anketues sipas mostrës.

Në këtë anketë janë të përfshira kompanitë regjionale dhe private të cilat mirren me menaxhimin e mbeturinave komunale në Kosovë (të licencuara).

Korniza e mostrës sipas ASK-së dhe regjistrit të biznesit ka qenë 38 kompani në sektorët e mostruar.

Mostra e AMK 2014 është përbërë prej 38 bizneseve, ndërsa numri i bizneseve që janë përgjigjur në anketë ka qenë 21 (duke përfshirë dhe kompanitë regjionale për menaxhimin e mbeturinave).

1.2.2 Procedurat në terren

Puna në terren është realizuar nga anketuesit të cilet kanë zhvilluar intervista të drejpërdrejta me menaxherët e kompanive në rajonin e tyre, duke u bazuar në pyetësorë (Aneksi1).

Kontrollimi i të dhënave është bërë në dy nivele:

- Kontrollimi i pyetësorëve të kompletuar në terren nga mbikqyrësit e terrenit.
- Kontrollimi i pyetësorëve të kompletuar në zyrën qendrore në ASK-së, nga stafi i sektorit të mjedisit.

2. Definicioni

Mbeturinat Komunale - janë mbeturina nga amvisëritë, po ashtu edhe mbeturina nga aktivitetet tjera të cilat për shkak të përbërjes dhe natyrës së tyre, janë të ngjashme me ato të amvisërisë.


3. REZULTATET E ANKETËS SË MBETURINAVE KOMUNALE 2014

Tabela 1: Mbeturina komunale të grumbulluara sipa tipit (BK, DMD) 2014

Vendi i grumbullimit	Banesa Kolektive	Derë më Derë	Gjithsej
Njësia	1000 ton		
Prishtina dhe regjioni ¹	17,446	77,283	94,729
Regjionet tjera	27,504	124,771	152,275
Kosova gjithsej	44,950	202,054	247,004

Gjithsej sasia e mbeturinave komunale të grumbulluara në Kosovë për vitin 2014, ka qenë 247 004 ton. Në Kosovë grumbullimi i mbeturinave derë më derë ishte 82 përqind, ndërsa në banimin kolektiv ka qenë 18 përqind (grafiku 1).

Grafiku 1: Struktura e mbeturinave komunale të grumbulluara në vitin 2014 në %



¹Prishtina, Obiliqi, Gllogovci, Fushë Kosova, Lipjani, Podujeva dhe Graçanica

Tabela 2: Mbeturinat komunale për banorë në vitin dhe ditë 2014

Vendi i grumbullimit	Sasia e grumbulluar	Popullsia ²	Mbeturina/kg/banorë/vit	Mbeturina/banorë/ditë
Njësia	1000/ton		kg/banorë	
Prishtina dhe regjioni	94,729	489,846	193	0.5
Regjionet tjera	152,275	1,275,532	119	0.3
Kosova gjithsej	247,004	1,765,378	140	0.4

Në Kosovë të dhënat e vitit 2014 tregojnë se mesatarja e mbeturinave komunale të grumbulluara ka qenë 140 kg për banorë në vit. Ndërsa dallime të theksuara vërehen ndërmjet regjioneve, si p.sh.në regjionet tjera në Kosovë sasia e mbeturinave komunale të grumbulluara ka qenë 119 kg për banorë në vit.

Në Prishtinë dhe regjionin e sajë grumbullimi i mbeturinave komunale ka qenë 0.5 kg në ditë për banorë.

Për pjesën tjetër të Kosovës sasia e mbeturinave komunale të gjeneruara për banorë në ditë ka qenë 0.3 kg (shiko tabelën 2).

Në Kosovë, mesatarja e mbeturinave të grumbulluara për banorë në ditë ka qenë 0.4 kg mbeturina/banorë/ditë.

² ASK të dhënat përfundimtare të vlerësuara për vitin 2014 (31 dhjetor 2014) sipas komunave.

4. Krahasimi i të dhënave për vitet 2007-2014

Tabela 3: Mbeturinat komunale të grumbulluara nga viti 2007-2014.

	2007	2008	2009	2010 ³	2011	2012	2013	2014
Njësia në 1000 ton								
Prishtina dhe regjioni	182	198	218	222	230	249	255	95
Regjionet tjera	148	153	187	293	352	358	320	152
Kosova gjithsej	330	351	405	515	582	607	575	247
Njësia në kg/banorë, v								
Prishtina dhe regjioni	364	396	436	511	488	515	517	193
Regjionet tjera	93	96	117	226	278	269	242	119
Kosova gjithsej	157	167	193	297	335	334	317	140
Njësia në kg/banorë, d								
Prishtina dhe regjioni	1.0	1.1	1.2	1.4	1.3	1.4	1.4	0.5
Regjionet tjera	0.3	0.3	0.3	0.6	0.8	0.7	0.7	0.3
Kosova gjithsej	0.4	0.5	0.5	0.8	0.9	0.9	0.9	0.4

Të dhënat e mbeturive komunale të grumbulluara sipas viteve 2007-2014, tregojnë se mbeturinat e grumbulluara sipas vendit të grumbullimit kanë dallime të theksuara sasiore nga viti në vit, kjo dukuri vërehet sidomos në vitet 2009-2013 (Fig.1).

Gjithashtu të dhënat e grumbulluara për banorë në vit/kg, tregojnë se dallime më të theksuara sasiore janë vërejtur nga vitet 2009-2014 (Fig.2).

³ Që nga viti 2010, sasia e mbeturive komunale për banorë është llogaritur në bazë të të dhënave të Regjistrimit të Popullsisë 2011 (për vitin 2010 të dhëna preliminare, ndërsa për vitin 2011, të dhëna përfundimtare). Rritja e lartë e mbeturive komunale për banorë nga vitet 2009-2010 është rezultat i ndikuar kryesisht nga të dhënat më numër më të ulët të popullsisë që nga viti 2011.

Figura 1: Grumbullimi i mbeturinave komunale sipas viteve 2007-2014, në ton

Grumbullimi i mbeturinave komunale sipas viteve 2007-2014, ton




Figura 2: Grumbullimi i mbeturinave komunale 2014, kg/banorë në vit, sipas viteve 2007-2014

Grumbullimi i mbeturinave komunale sipas viteve 2007-2014, kg/banorë/vit




Tabela 4: Mbeturinat komunale të grumbulluara sipas viteve 2007-2014 sipas sistemit të grumbullimit (BK dhe DMD).

	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Banesa kolektive në 1000 ton								
Prishtina dhe regjioni	88	82	98	92	97	99	101	17
Regjionet tjera	56	45	76	131	145	150	127	28
Kosova gjithsej	144	127	174	223	242	249	228	45
Derë më Derë në 1000 ton								
Prishtina dhe regjioni	94	116	120	130	133	149	154	77
Regjionet tjera	92	108	111	162	207	209	191	125
Gjithsej Kosova	144	224	231	292	340	358	345	202
Kosova gjithsej në 1000 ton								
Prishtina dhe regjioni	182	198	218	222	230	249	255	95
Regjionet tjera	148	153	187	293	352	358	318	152
Kosova gjithsej	330	351	405	515	582	607	573	247

Gjithsej sasia e mbeturinave komunale të grumbulluara në Prishtinë dhe regjion ka qenë 94 726 ton, kurse ne regjionet tjera ka qenë 152 275 ton.

Aneks 1. Pyetësi

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

628.54(496.51-2) “2014”(084.2)

Anketa e mbeturinave komunale : 2014 / Përgatiten Bajrush Qevani.. et al..]. - Prishtinë : Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2015. - 18 f. : ilustr. ; 28 cm. - (Seria ; 2 : Statistikat e Bujqësisë dhe Mjedisit)

Parathënie / Isa Krasniqi: f. 2

1. Qevani, Bajrush 2.Kurti, Haki 3.Shosholli, Flutura 4. Osmani, Liridona

ISBN 978-9951-22-248-8

Agjencija e Statistikave të Kosovës përshkrim i shkurtër

Agjencija e Statistikave të Kosovës, është institucion profesional, i cili vepron që nga viti 1948 dhe ka kaluar disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe. Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën profesionale, si i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Agjencioni financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe donatorë për projekte të veçanta.

Agjencia e Statistikave të Kosovës vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011. Plani zhvillimor strategjik 2009-2013 është në implementim afatmesëm për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

Misioni i Agjencionit, është që të përmbush nevojat e përdoruesve me të dhëna statistikore objektive dhe analiza të rregullta në mënyrë që të përkrah departamentet qeveritare, t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

Adresa: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Rr. "Zenel Salihu" Nr.4, Prishtinë

Telefonat: +381 (0) 31 129

Kryeshefi ekzekutiv : +381 (0) 38 200 31 112

Fax: +381 (0) 38 235 033

E-mail: agricultural@ks-gov.net

Ueb-faqe: <http://ask.rks-gov.net/>

ISBN 978-9951-22-248-8



9 789951 222488